



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 24

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 21 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10730, datë 14.2.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	1945
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 14.2.2018	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara.....	1945
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 58, datë 8.2.2018	Për përdorimin e ëmbëlsuesit ushqimor “E 955 Sucralose”, në produktet ushqimore.....	1947
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 12.2.2018	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017, “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.....	1950
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 62, datë 9.2.2018	Për miratimin e rregullave për marrjen e masave për eliminimin e kafshëve.....	1950
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 14.2.2018	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të nenit 91/4, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në pjesën ku parashikon se vetëm femrat mund të përfitojnë periudhë sigurimi për efekt llogaritjeje pensioni, për afatin e kryerjes së studimeve të shkollës së lartë, duke përjashtuar nga kjo e drejtë meshkujt.....	1953
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 2, datë 19.1.2018	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë.....	1958

Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 10, datë 19.2.2018	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	1958
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzo Veip Kucuku.....	1960

**DEKRET**

Nr. 10730, datë 14.2.2018

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 20 dhe nenit 9, pika 7, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministres së Kulturës, ministres së Mbrojtjes dhe ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Fatos Feti Islami
2. Orhan Kurtesh Hajrizi
3. Arta Muharrem Rama Hajrizi (Rama)
4. Teuta Bedrudin Sahatqija (Celina)
5. Nexhmi Isak Krasniqi
6. Vera Ibrahim Hoti
7. Besim Nuhi Ajeti
8. Atdhe Shemsedin Mulla
9. Jetmir Januz Salihu
10. Enver Adil Dugolli
11. Argjend Bedri Malaj
12. Jeton Riza Neziraj
13. Blerta Rustem Neziraj (Rustemi).

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 81, datë 14.2.2018

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË SË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

1. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në vijim “Agjencia”, organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Brendshëm, në vijim ministri, me seli në Tiranë.

2. Agjencia, si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ka si mision kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës.

3. Agjencia ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Brendshme.

4. Agjencia ka stemën dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

5. Agjencia drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj Agjencie dhe përgjigjet para ministrit.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri.

7. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm.



8. Shërbimet mbështetëse dhe ato të buxhetit e të financës për Agjencinë realizohen nga strukturat përgjegjëse për këto funksione në Ministrinë e Brendshme.

9. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË

11. Agjencia kryen detyrat, si më poshtë vijon:

11.1. Në rastin kur kryen procedura prokurimi për të nënshkruar marrëveshje kuadër:

a) zhvillon procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër;

b) përllogarit fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen;

c) unifikon specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendës a të huaj, dhe harton katalogët e standardeve, të cilët miratohen me udhëzim të ministrit;

ç) shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër;

d) në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa për kryerjen e procedurës së prokurimit, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, Agjencia verifikon arsyet e vonës, shpall procedurën e re të prokurimit për këto kërkesa dhe njofton Agjencinë e Prokurimit Publik;

dh) monitoron, në çdo kohë, zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore dhe për këtë qëllim harton një raport për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

11.2 Në rastin kur Agjencia kryen procedura prokurimi për të lidhur kontratë, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Zhvillon procedurat e prokurimit të përqendruar të mallrave dhe të shërbimeve deri në shpalljen e fituesit;

b) Bashkërendon punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të

dhënave për prokurimet publike që do të zhvillojë si organ qendror blerës;

c) Unifikon specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendës a të huaj, dhe harton katalogët e standardeve, të cilët miratohen me udhëzim të ministrit;

ç) Verifikon përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;

d) Përllogarit fondin limit për përcaktimin e të dhënave sasiore për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen, para publikimit të tenderit, dhe vë në dijeni autoritetet kontraktore;

dh) Shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit;

e) Në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa për kryerjen e procedurës së prokurimit, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, Agjencia verifikon arsyet e vonës, shpall procedurën e re të prokurimit për këto kërkesa dhe njofton Agjencinë e Prokurimit Publik;

ë) Monitoron në çdo kohë zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore. Në përfundim të monitorimit harton një raport për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

12. Për nëpunësit civilë aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara, në rastin e ristrukturimit të institucionit, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil.

13. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

14. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**UDHËZIM****Nr. 58, datë 8.2.2018****PËR PËRDORIMIN E ËMBËLSUESIT
USHQIMOR “E 955 SUCRALOSE”, NË
PRODUKTET USHQIMORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 41, pika 12, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përdorimin e aditivit ushqimor “E 955 Sucralose” në produktet ushqimore sipas kushteve të dhëna në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Urdhri nr. 698, datë 16.12.2003, “Mbi përdorimin e disa ëmbëlsuesve ushqimorë në produktet ushqimore”, i ndryshuar, mbetet në fuqi për sa kohë nuk bie në kundërshtim me këtë udhëzim.

3. Ngarkohet Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi

SHTOJCË**KUSHTET E PËRDORIMIT TË ËMBËLSUESIT USHQIMOR “E 955 SUCRALOSE” SIPAS
KATEGORIVE TË USHQIMEVE¹**

Nr. E	Emri	Produkti ushqimor	Niveli maksimal (mg/l ose mg/kg sipas nevojës)	Kufizimet/përrjashtime
E 955	Sucralose	Produktet e qumështit, të fermentuara, duke përfshirë produktet e trajtuara me nxehtësi	400	Vetëm produkte me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		Ushqime të ngrënshme	320	Vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		Fruta dhe perime në uthull, vaj ose shëllirë	180	Vetëm konservat e ëmbla-të tharta të frutave dhe perimeve
		Fruta dhe perime të konservuara ose në shishe	400	Vetëm me energji të reduktuar të frutave ose pa sheqer të shtuar
		Përgatitjet e frutave dhe perimeve, përjashtuar kompostoja	400	Vetëm me energji të reduktuar
		Reçel dhe xhel shtesë	400	Vetëm reçel, xhel dhe marmelatë me energji të reduktuar
		Reçel, xhel dhe marmelatë, dhe pure e ëmbël gështenjash	400	Vetëm reçel, xhel dhe marmelatë me energji të reduktuar
		Shpërndarje të ngjashme të frutave apo perimeve	400	Vetëm fruta të thata të vendosura në formë shumështrësash, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		Kakao dhe produkte çokollate	800	Vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar

¹ Ky udhëzim ka përafuar pjesërisht rregulloren nr. 129/2011, të datës 11 nëntor 2011, që amendon aneksin II, të rregullores (KE) nr. 1333/2008, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, duke krijuar një listë të aditivëve ushqimorë, Celex 2011R1129, FZ L 295, 12.11.2011, f. 1.



		Kakao dhe produkte çokollate	800	Vetëm kakao ose fruta të thata, me energji të reduktuar ose pa sheqer shtuar
		Ëmbëlsira të tjera duke përfshirë karamelët për frymëmarrje të freskët	200	Vetëm ëmbëlsira në formë tablete me energji të reduktuar
		Ëmbëlsira të tjera duke përfshirë karamelët për frymëmarrje të freskët	400	Vetëm qumësht kakao, fruta të thata ose sanduiç me bazë yndyrë, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		Ëmbëlsira të tjera duke përfshirë karamelët për frymëmarrje të freskët	1 000	Vetëm ëmbëlsira me energji të reduktuar me bazë niseshteje ose pa sheqer të shtuar
		Ëmbëlsira të tjera duke përfshirë karamelët për frymëmarrje të freskët	1 000	Vetëm ëmbëlsira pa sheqer të shtuar
		Ëmbëlsira të tjera duke përfshirë karamelët për frymëmarrje të freskët	2 400	Vetëm karamelë për frymëmarrje të freskët, pa sheqer të shtuar
		Ëmbëlsira të tjera duke përfshirë karamelët për frymëmarrje të freskët	1 000	Vetëm tableta me aromë të fortë për freskimin e fytyrës pa sheqer të shtuar.
		Çamçakëz	1 200	Vetëm me sheqer ose poliole të shtuara, si nxitës i aromës
		Çamçakëz	3 000	Vetëm pa sheqer të shtuar
		Dekorime, veshje dhe mbushje, përveç mbushjeve me bazë frutash	1 000	Vetëm me energji të reduktuar të ëmbëlsirave me bazë niseshteje ose pa sheqer të shtuar
		Dekorime, veshje dhe mbushje, përveç mbushjeve me bazë frutash	1 000	Vetëm ëmbëlsira pa sheqer të shtuar
		Dekorime, veshje dhe mbushje, përveç mbushjeve me bazë frutash	800	Vetëm kakao ose fruta të thata, me energji të reduktuar ose pa sheqer shtuar
			450	Vetëm salcat
		Drithërat e mëngjesit	400	Vetëm drithërat për mëngjes, me përmbajtje fibre prej jo më shumë se 15% dhe që përmbajnë të paktën 20% krunde, me energji të reduktuar ose pa sheqer shtuar
		Produkte të bukës	800	Vetëm kornet dhe vafer për akullore, pa sheqer të shtuar
		Produkte të bukës	700	Vetëm produkte të bukës për përdorime të veçanta ushqyese
		Peshqit e përpunuar dhe produktet e peshkimit përfshirë molusqet dhe krustacet	120	Vetëm konservat e ëmbla-të tharta dhe gjysmë të konservuara të peshkut dhe marinadave



				të peshkut, krustaceve dhe molusqeve
		Ëmbëlsira tavoline në formë të lëngshme	Sasi e mjaftueshme	
		Ëmbëlsira tavoline në formë pluhuri	Sasi e mjaftueshme	
		Mustard	140	
		Supëra	45	Vetëm supë me energji të reduktuar
		Salca	450	
		Sallatë dhe përzierjet sanduiç me bazë pikante	140	Vetëm sallatë me feinkost
		Ushqime dietetike për qëllime të veçanta mjekësore	400	
		Ushqime dietetike për dietat e kontrollit të peshës, të destinuara për të zëvendësuar konsumimin total të përditshëm të ushqimit ose një vakt individual (të gjithë ose një pjesë të dietës së përgjithshme ditore)	320	
		Nektar frutash	300	Vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		Pije të aromatizuara	300	Vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		Pije alkoolike, duke përfshirë të ngjashme pa alkool dhe alkool të ulët		
		Birra dhe pije malt	250	Vetëm birrë pa alkool ose me përmbajtje alkooli jo më tepër se 1,2% vol; “ <i>Bière de table/Tafelbier</i> ”/birrë tavoline” (përmbajtja origjinale e <i>wort</i> , më pak se 6%), me përjashtim të “ <i>Obergäriges Einfachbier</i> ”; Birra me një aciditet minimal prej 30 mili-ekuivalente, shprehur si NaOH; Birra të bardha të llojit “ <i>oud bruin</i> ”
		Birra dhe pije malt	10	Vetëm birrë me energji të reduktuar
		Musht dhe perri	50	
		Pije të tjera alkoolike përfshirë përzierjet e pijeve alkoolike me pije joalkoolike dhe alkoolike me më pak se 15% të alkoolit	250	
		<i>Snack</i> të bazuara në patate, drithëra, miell ose niseshte	200	
		Arra	200	
		Ëmbëlsirat përfshirë produktet e mbuluara në kategoritë 1, 3 dhe 4	400	Vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
		Shtesat ushqimore në formë të ngurtë, duke përfshirë kapsulat dhe tabletat dhe format e ngjashme, me përjashtim të formave të tabletave që përtypen	800	
		Shtesat ushqimore në formë të lëngët	240	
		Shtesat ushqimore në formë të llojit të shurupit ose të çamçakëzit	2 400	

**UDHËZIM****Nr. 1, datë 12.2.2018****PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
NR. 25, DATË 10.11.2017,
“PËR REGJISTRIMIN E FORMAVE TË
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE
NË REGJISTRIN SHTETËROR
TË DIPLOMAVE DHE TË
CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN
E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, dhe pikës 3, të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “a”, e pikës 2, e nenit 4, ndryshon si më poshtë:

“a) Kërkesa për regjistrim (me vulën e IAL-së dhe firmosur nga rektori), në të cilën deklarohet numri dhe data e:

i) Vendimit të Senatit Akademik për miratimin e formës së diplomës, për çdo cikël dhe lloj programi studimi;

ii) Aktit të hapjes së IAL-së;

iii) Aktit të akreditimit të IAL-së;

iv) Aktit të hapjes së programit të studimit për të cilin regjistrohet diploma;

v) Aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin regjistrohet diploma.”.

2. Shkronjat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f” të pikës 2, të nenit 4, shfuqizohen.

3. Shkronja “h”, e pikës 2, e nenit 4, ndryshon si më poshtë:

“h. Dokumenti i pagesës së tarifës për regjistrim, në regjistrin shtetëror, për llogari të QSHA-së (dokumenti të jetë origjinal ose kopje e noterizuar)”.

4. Pika 3, e nenit 4, shfuqizohet.

5. Pika 2, e nenit 14, shfuqizohet.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

URDHËR**Nr. 62, datë 9.2.2018****PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
MARRJEN E MASAVE PËR ELIMINIMIN
E KAFSHËVE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Eliminimi i kafshëve, për të cilat është vendosur masa e eliminimit të tyre brenda 72 orëve, të kryhet nëpërmjet metodës së eutanazisë.

2. Eutanazia e kafshëve të kryhet nga mjeku veterinar që ushtron praktikën mjekësore veterinare, në subjektin që është vendosur eliminimi i kafshëve.

3. Eutanazia të kryhet me një produkt mjekësor veterinar të miratuar.

4. Strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore organizojnë mbledhjen e kadavrave të kafshëve për të cilat është kryer eutanazia dhe të përcaktojnë vendet e groposjes ose të grumbullimit të tyre.

5. Groposja e kafshëve të eliminuara bëhet në zbatim të procedurave që ndiqen për eliminimin e kafshëve në shtojcën 1 bashkëngjitur.

6. Groposja e kadavrave të kafshëve të eliminuara bëhet nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit të qeverisjes vendore, në përbërjen e të cilit janë veterineri privat i subjektit, veterineri zyrtar i shërbimit veterinar rajonal, veterineri në njësinë e qeverisjes vendore dhe përfaqësuesi i administratës së njësisë vendore.

7. Procesverbali për groposjen e kadavrave mbahet në tri kopje, një nga të cilat e mban pronari i kafshës. Modeli i procesverbalit të



groposjes së kadavrave jepet në shtojcën 2 bashkëlidhur.

8. Groposja ose, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, drejtoritë e bujqësive në qarqe dhe strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi

SHTOJCA 1
ASGJËSIMI I SIGURT I KARKASËS SË
KAFSHËVE TË ELIMINUARA ME
EUTANAZI

Kadavrat e kafshëve të eliminuara me eutanazi duhet të bëhet nëpërmjet metodës së groposjes së thellë.

Groposja e thellë

Nëse duhet të groposen një ose disa karkasa, atëherë rekomandohet groposja në vend për të minimizuar mundësinë e kontaktit me karkasën dhe përhapjen e mundshme të kontaminimit, sikurse edhe për të minimizuar kontaktin e njerëzve me kafshët. Gropa duhet të hapet në vendin e duhur për të shmangur kontaminimin e ujit nëntokësor. Ndiqni udhëzimet si më poshtë:

- Duhet të gërmohet një gropë të paktën 2 metër e thellë. Pjesën më të lartë të karkasës duhet ta vendosim të paktën një metër poshtë nivelit të sipërfaqes fillestare të tokës.

- Mbulojmë mirë karkasën me gëlqere të shuar. Spërkatim shtresën e gëlqeres me ujë për të ndihmuar prodhimin e kufizuar të lëngshëm.

- Mbulojmë karkasën me dhe.

Nëse duhet të eliminohet një karkasë e vetme apo disa karkasa, zgjedhja më e mirë për të bërë këtë është groposja në të njëjtin vend. Nëse duhet të eliminohen shumë karkasa, duhet të zgjidhet një vend i posaçëm groposjeje.

Groposja e një numri të madh kafshësh

Nëse duhet të eliminohen më shumë karkasa, atëherë duhet të zgjidhet vendi i duhur për këtë groposje. Për këtë duhet të merren parasysh udhëzimet e mëposhtme:

- Hapim gropën, të paktën, 150 metra nga çdo vend ku ka ujë sipërfaqësor dhe puse.

- Shmangim groposjen në toka tepër të depërtueshme, si në zhavor, rërë ose tokë të shkrifët dhe gjithashtu shmangim groposjen në ambiente që mund të karakterizohen nga këto lloje tokash.

- Shmangim vendosjen e më shumë se një karkase të një kafshe të madhe, në një shtresë. Karkasat e kafshëve të vogla mund t'i vendosim në një shtresë jo më të lartë se të një kafshe të madhe.

- Duhet jo më tepër se një shtresë kafshësh në një groposje aty ku toka nuk është me shtresa kompozite.

- Në asnjë rast nuk duhet të kemi më shumë sesa dy shtresa kafshësh. Ndiqni udhëzimet:

- Gërmojmë afërsisht zonën në një thellësi tre metra me buldozer.

- Baza e gërmimit duhet të jetë të paktën 3 metra mbi nivelin e njohur të ujit të tokës.

- Vendosim karkasat (një kafshë e madhe në një shtresë, karkasat e kafshëve të vogla në një lartësi jo më të madhe sesa ajo e një kafshe të madhe).

- E mbulojmë mirë me gëlqere të shuar dhe e spërkatim me ujë.

- E mbulojmë mirë e në mënyrë të barabartë me dhe që të mos duket karkasa.

- Vendosim shtresën e dytë të karkasës.

- E mbulojmë me gëlqere të shuar, e spërkatim me ujë dhe e mbulojmë me dhe. Ngjeshim pjesën e mbetur të dheut.

Konsiderata të përgjithshme

- Karkasa duhet të qëndrojë e pahapur.

- Eliminimi duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e veterinerit zyrtar të shërbimit veterinar rajonal.

- Ndiqni udhëzimet sipas legjislacionit veterinar në fuqi.

- Karkasën duhet ta mbrojmë nga kafshët e tjera shtëpiake përfshi këtu mishngrënësit dhe nga kafshët që ushqehen me këрма.

- Duhet të shmangim tërheqjen zvarrë të karkasës. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të tregojmë kujdes për marrjen dhe heqjen e dheut të kontaminuar të cilin duhet ta eliminojmë së bashku me karkasën.



SHTOJCA 2

LOGO

PROCESVERBAL
PËR GROPOSJEN E KAFSHËS

I mbajtur sot, në datën _____._____._____, në _____, Njësine Administrative _____, Qarku _____, në prezencë të komisionit të ngritur me urdhrin nr.____, datë _____._____._____, të titullarit të qeverisjes vendore _____, mbi groposjen e kafshës/ve, si më poshtë:

Lloji i kafshës/ve _____

Nr. i krerëve _____

Numri/at i/e identifikimit të kafshës/ve _____

Mosha _____

Raca _____

Kodi i fermës/subjekti _____

Pronari i kafshës _____

Nr. i identifikimit të pronarit (kartë identiteti/pasaportë) _____

Groposja e kafshës/ve u krye pas vendimit të marrë, në përputhje me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Groposja u krye në vendin e quajtur _____, i miratuar nga njësia e qeverisjes vendore.

Procesverbali mbahet në tri kopje të njëjta origjinale, nga të cilat njëra i lihet pronarit të kafshës së eliminuar, njëra i dorëzohet veterinerit zyrtar të shërbimit veterinar rajonal dhe tjetra qëndron në strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore.

KOMISIONI

Veterineri privat i subjektit

.....
(emër, mbiemër, firmë)

Veterineri në njësitë e qeverisjes vendore

.....
(emër, mbiemër, firmë)

Veterineri zyrtar i shërbimit veterinar rajonal

.....
(emër, mbiemër, firmë)

**Përfaqësuesi i administratës së njësisë
vendore**

.....
(emër, mbiemër, firmë)



VENDIM

Nr. 4, datë 14.2.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “

në datën 20.12.2017, me sekretare Belma Lleshi,
mori në shqyrtim në seancë, mbi bazë
dokumentesh, çështjen me nr. 63 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata Administrative e
Shkallës së Parë Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi,
në mungesë, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga
z. Artur Metani, Instituti i Sigurimeve Shoqërore
(ISSH), përfaqësuar nga z. Astrit Hado.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i nenit
91/4, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për
sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,
në pjesën ku parashikon se vetëm femrat mund të
përfitojnë periudhë sigurimi për efekt llogaritjeje
pensionit, për afatin e kryerjes së studimeve të
shkollës së lartë, duke përfshirë nga kjo e drejtë
meshkujt.

BAZA LIGJORE: Neni 145/2 i Kushtetutës së
Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 68, i ligjit nr.
8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe
feksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës
së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Bashkim Dedja,
shqyrtoi kërkesën e kërkuës, që kërkoj pranimin e
saj, dhe prapësimet e subjekteve të interesuara,
Këshilli i Ministrave dhe Instituti i Sigurimeve
Shoqërore, të cilat kërkuar rrëzimin e kërkesës, si
dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë
Vlorë (gjykata referuese) ka marrë në shqyrtim
çështjen me kërkuës A.XH. dhe të paditur
Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore,
person i tretë Avokatura e Shtetit, si dhe objekt
detyrimin e palës së paditur të llogarisë vjetërsinë
në punë të paditësit për periudhën 1.9.1971-
31.8.1974, kur ka kryer studimet në Shkollën e
Lartë të Marinës; periudhën 1.1.1995–31.2.1995,
kur është paguar dhe siguruar me pagë kalimtare;
periudhën 1.1.1996–31.12.1998, si dhe detyrimin e
palës së paditur që për periudhën 1.1.1999–
1.7.2009 të kryejë llogaritjet mbi bazën e pagës
referuese 14.380 lekë.

2. Gjykata referuese, me vendimin e
ndërmjetëm nr.--, datë 19.9.2017, i ka kërkuar
Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë
papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 91/4, të
ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet
shoqërore”, me ndryshimet përkatëse², ku është
parashikuar sa vijon: “*Periudha e kryerjes së studimeve
në shkollën e lartë, me shpëputje nga puna për gruan, duke
filluar nga data 1.9.2000 dhe deri më 31.12.2032,
pavarësisht nga vendi ku janë kryer studimet dhe jo për më
shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi për efekt pensioni
pleqërie. Në kuptim të këtij neni viti shkollor është 12
muaj. Në këtë rast, kontributet përballohen nga buxheti i
shtetit, në kohën kur merret vendim për caktimin e
pensionit*”.

II

3. *Sipas gjykatës referuese* neni i sipërcituar
bie ndesh me parimin kushtetues të barazisë dhe
mosdiskriminimit, si dhe jurispruclencën e Gjykatës

² Ligjet ndryshuese nr. 7932, datë 17.5.1995; nr. 8286, datë
16.2.1998; nr. 8392, datë 2.9.1998; nr. 8575, datë 3.2.2000;
nr. 8776, datë 26.4.2001; nr. 8852, datë 27.12.2001; nr.
8889, datë 25.4.2002; nr. 9058, datë 20.3.2003; nr. 9114,
datë 24.7.2003; nr. 9377, datë 21.4.2005; nr. 9498, datë
3.4.2006; nr. 9600, datë 27.7.2006; nr. 9708, datë 5.4.2007;
nr. 9768, datë 9.7.2007; nr. 10070, datë 5.2.2009; nr. 10447,
datë 14.7.2011; nr. 13/2014, datë 13.2.2014; nr. 104/2014,
datë 31.7.2014; nr. 144/2015; datë 17.12.2015; nr.
111/2016; datë 3.11.2016.

Akt Normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë
25.1.2017; nr. 25/2017; datë 9.3.2017.



Kushtetuese, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto argumente:

3.1 Ekziston lidhja e drejtpërdrejtë midis dispozitës që çmohet si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, pasi kjo dispozitë është e nevojshme për t'u aplikuar në çështjen konkrete dhe gjykimi i filluar prej gjykatës referuese varet nga përfundimi i gjykimit në Gjykatën Kushtetuese.

3.2 Neni 91/4 i ligjit bie ndesh me parimin e barazisë, nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ-së. Ky nen krijon diskriminim mes burrave dhe grave, në mënyrë të papërligjur dhe objektive, duke mos respektuar standardet e nenit 18/3 të Kushtetutës. Trajtimi i privilegjuar i femrave ose, ndryshe, diskriminimi pozitiv, nuk diktohet nga rrethana objektive, aq më tepër që nuk është gjetur mjeti proporcional në raport me rrethanat e krijuara apo synimin e kërkuar.

3.3 Nga jurisprudenca e GJEDNJ-së rezulton se trajtimi i diferencuar, duke pasur si bazë gjininë, si rregull konsiderohet diskriminim, përveç rasteve kur provohet se një trajtim i tillë kryhet për shkaqe “veçanërisht shumë të rëndësishme”.

3.4 Marrëdhëniet e sigurimeve shoqërore lidhen ngushtësisht me marrëdhëniet e punës. Si rrjedhim, parimet që rëndojnë marrëdhëniet e punës, rëndojnë edhe marrëdhëniet e sigurimeve shoqërore. Sipas Kodit të Punës, të gjithë punëmarrësit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga punëdhënësit dhe, vetëm kur ka situata të ndryshme, si në rastin e moshës, aftësisë së kufizuar, përgjegjësisë prindërore etj., atëherë mund të kemi trajtim të diferencuar të arsyeshëm, gjë që në rastin konkret nuk ekziston, pasi nuk ka një arsye të përligjur për diferencimin.

3.5 Është i përligjur dhe i arsyeshëm trajtimi i diferencuar i grave në rastet e lejes së lindjes në afat më të gjatë se meshkujt baballarë (*neni 105 i KP-së*) apo dalja e grave në pension kur kanë lindur mbi 6 fëmijë dhe më i vogli është 8 vjeç (*neni 93 i ligjit nr. 7932*), pasi bazohen në rrethana objektive të lidhura me sjelljen në jetë të një fëmije apo pamundësinë fizike të gërshetuar me moshë të një nëne që ka sjellë në jetë 6 fëmijë, ndërkohë që në rastin konkret privilegjimi i grave nuk është objektiv.

3.6 Sipas zhvillimit historik të legjislacionit shqiptar apo në vështrim krahasimor me legjislacionin polak dhe italian, nuk ka diferencime

në periudhën e sigurimit shoqëror bazuar mbi gjininë, për efekt të llogaritjes së pensionit.

4. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar me këto argumente:

4.1 Gjykata referuese i ka të gjitha mundësitë për ta zgjidhur çështjen në mënyrë të pavarur. Paditësi ka mbushur moshën e pensionit dhe ka plotësuar maksimumin e vjetërsisë. Paditësi ka mbushur moshën 65 vjeç dhe ka 35 vjet e 8 muaj vjetërsi në punë, kështu që edhe sikur t'i shtoheshin vitet që ka kryer shkollën e lartë, përsëri masa e pensionit do të ishte e njëjtë.

4.2 Gjykata duhet të kishte vazhduar gjykimin e çështjes pa cenuar parimin e një gjykimi të shpejtë dhe efektiv.

4.3 Dispozita e kundërshtuar nuk bie në kundërshtim, por e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës. Për të përfituar pension pleqërie duhet të plotësohen dy kushte: moshë dhe periudha e sigurimit. Përfitueset gra nga viti 2000 deri në vitin 2032 nuk arrijnë të plotësojnë njërin nga kushtet, periudhën e sigurimit në momentin e plotësimit të moshës për pension, pa përfshirë periudhën e studimit në shkollat e larta. Pas vitit 2032, për përfitim pensioni, nuk do të përfshihet më periudha e shkollës së lartë. Diskriminimi pozitiv në rastin konkret është vendosur bazuar në shkaqe të përligjura dhe rrethana objektive.

5. **Subjekti i interesuar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se neni 91/4 i ligjit i jep mundësi të barabarta si burrave dhe grave të përmbushin periudhat e sigurimit sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës. Ky nen ka vendosur diskriminim pozitiv për femrat.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

6. Neni 145/2 i Kushtetutës parashikon se “kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese”. Ndërsa, sipas nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, gjykata apo gjyqtari është i detyruar, kur çmon se ligji është antikushtetues, të argumentojë para Gjykatës Kushtetuese ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë



midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

7. Gjykata është shprehur vazhdimisht për aspektet e legjitimitetit të gjykatave, të cilat e vënë në lëvizje atë nëpërmjet kontrollit incidental. Sipas saj, gjykata ose gjyqtari, i cili kërkon kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese, duhet të respektojë disa kritere: *së pari*, gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; *së dyti*, duhet të parashtrorë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit), duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; *së treti*, duhet të ekzistojë raporti i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese; *së katërti*, para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 50, datë 10.7.2015; nr. 9, datë 26.2.2016; nr. 80, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata vlerëson nëse gjykata referuese kishte mundësi ta zgjidhte çështjen në mënyrë të pavarur, duke mos iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, si kriter legjitimiteti në kontrollin incidental të ligjeve.

9. Gjykata konstaton se në rastin objekt shqyrtimi gjykata referuese ka pasur në shqyrtim çështjen administrative për llogaritjen si vjetërsi periudhe të sigurimit të paditësit për vitet e shkollës së lartë. Nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave, duke pretenduar moslegjitimitetin e gjykatës, për kontrollin incidental të normës, ka parashtruar se dispozita në fjalë nuk ndryshon asgjë nga perspektiva e themelit të çështjes konkrete, pasi në përfundim, me vitet e shkollës së lartë ose pa vitet e shkollës së lartë, masa e pensionit të paditësit nuk ndryshon, pasi ai plotëson vitet dhe periudhën e sigurimit për pension pleqërie.

10. Gjykata vëren se kërkesa e paditësit në gjykimin e çështjes mbështetet në kërtime për të cilat nuk ekziston normë ligjore për të përfituar të drejtën e pretenduar prej tij. Pra, sikundër edhe gjykata referuese argumenton, neni 91/4 i ligjit për sigurimet shoqërore, me ndryshimet përkatëse, periudhën e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna, e njeh vetëm për gruan.

11. Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk pengohet nga verifikimi i kushtetutshmërisë së nenit në fjalë për ta zgjidhur në themel çështjen. Nisur nga fakti se paditësi e ka bazuar kërkimin e tij në ometim ligjor/boshllëk, ky element e detyron gjykatën për ta zgjidhur çështjen konkrete, duke u dhënë përgjigje kërtimeve të tij. Për më tepër, hipotetikisht, edhe sikur Gjykata Kushtetuese do ta kishte vlerësuar dispozitën ligjore të kundërshtuar si antikushtetuese, përsëri kjo nuk do të diktonte perspektivën e zgjidhjes së çështjes konkrete për shqyrtim pranë gjykatës referuese. Nëse Gjykata do ta shfuqizonte dispozitën e ankimuar, kjo nuk do të rregullonte pozitat e kërkesit, por do t'u hiqte trajtimin pozitiv grave në rastin konkret.

12. Si konkluzion, për sa më lart, gjykata referuese nuk plotëson kriteret e legjitimitetit, në kuptim të nenit 68, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", prandaj kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja "a", 134/1, shkronja "dh" dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe në nenet 68, 69, 70, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri³,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

³ Kryetari B. Dedja dhe gjyqtarja V. Tusha, kanë mbajtur qëndrim "pro" legjitimitetit të gjykatës referuese, por janë për rrëzimin e kërkesës për themelin e çështjes.



MENDIM PARALEL

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me linjën e arsytimit për këtë vendim, edhe pse jemi dakord me përfundimin e arritur në këtë çështje, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel për sa vijon.

1. Sipas shumicës, kërkesja nuk legjitimohet, sepse gjykata referuese nuk pengohet nga verifikimi i kushtetutshmërisë së nenit në fjalë për ta zgjidhur në themel çështjen, nisur nga fakti se paditësi e ka bazuar kërkimin e tij në ometim ligjor. Ky element e detyron gjykatën për ta zgjidhur çështjen konkrete, duke i dhënë përgjigje bazuar mbi kërkimet e tij (*§. 11 i vendimit*).

2. Në rastin konkret, konstatojmë se, gjykata referuese ka pasur në shqyrtim çështjen administrative për llogaritjen si vjetërsi periudhe të sigurimit të paditësit periudhën e shkollës së lartë. E vetmja dispozitë që e njeh këtë të drejtë është neni 91/4 i ligjit për sigurimet shoqërore dhe ua njeh vetëm grave.

3. Referuar nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, mendojmë se gjykata referuese legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së saj, pasi paditësi kërkon t’i njihen vitet e shkollës së lartë si vite sigurimi dhe kjo çështje ngrinte dyshime serioze antikushtetushmërie, për të cilën Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet.

4. Në vijim po paraqesim argumente edhe për thelbin e pretendimeve, në kushtet që kjo çështje ka kaluar në seancë gjyqësore.

5. Gjykata referuese pretendon se neni 91/4, i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore”, me ndryshimet përkatëse, bie ndesh me parimin e barazisë, nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ-së. Gjithashtu, kjo gjykatë, pretendon se ky nen krijon diskriminim mes burrave dhe grave në mënyrë të papërligjur dhe objektive, duke mos respektuar standardet e nenit 18/3 të Kushtetutës. Trajtimi i privilegjuar i femrave ose, ndryshe, diskriminimi pozitiv, nuk diktohet nga rrethana objektive dhe aq më tepër që nuk është gjetur mjeti proporcional në raport me rrethanat e krijuara apo synimin e kërkuar. Subjektet e interesuara, KM-ja dhe ISSH-ja pretendojnë se dispozita e ankimuar nuk bie në kundërshtim, por e konkretizon nenin 18 të

Kushtetutës, dhe është diskriminim pozitiv për femrat, mbi shkaqe të përligjura dhe objektive.

6. Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon diskriminimin mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përligjeje e arsyeshme dhe objektive.

7. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007; nr. 19, datë 9.7.2009; nr. 4, datë 12.2.2010; nr. 71, datë 27.11.2015; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar disa standarde për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues bazuar në kushtet dhe kriteret e nenit 18 të Kushtetutës. Në të tilla raste Gjykata shqyrton nëse ligji parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, në rast se e konstaton këtë fakt, ajo vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligjeje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënës të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (*shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Sigurimi shoqëror bazë është një e drejtë kushtetuese ekonomiko-sociale dhe si e tillë lidhet me detyrimin e shtetit për të qenë aktiv e për t’u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevoja jetësore në rastet e



fatkeqësive, sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar (*shih vendimet nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata edhe më parë është shprehur se faktorët që nxisin ndryshimet në sistemin e sigurimeve shoqërore mund të jenë çështje me interes të gjerë publik, si: përpjekja për ta bërë sa më të drejtë sistemin për të dyja palët (përfitues dhe kontribues), situata financiare e buxhetit, si dhe faktorë të tjerë socialë. Ndërhyrjet që mund t'i bëhen sistemit të pensioneve duhet t'i shërbejnë konsolidimit të tij dhe stabilitetit ekonomiko-financiar, me qëllim funksionimin e skemës së pensioneve sipas parimit që gjithkush ka të drejtën e përfitimit të një sigurimi sa më të mirë e të përshtatshëm me mënyrën e jetesës. Duke qenë e lidhur drejtpërdrejt me buxhetin e shtetit, përgjegjësia për mirëfunksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore është kompetencë ekskluzive e ligjvënësit në bashkëpunim me ekzekutivin. Natyrisht, është e pritshme që ndërhyrja e ligjvënësit në çdo rast të bëhet duke iu përmbajtur kufijve të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 2, datë 18.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Si rregull, shumë arsye të qenësishme mund ta justifikojnë një diferencim në trajtim, bazuar ekskluzivisht mbi gjininë si të pajtueshëm me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Van Raalte, § 39, dhe Schuler-Zraggen kundër Zvicrës, 24 qershor 1993, § 67*). Nga ana tjetër, një hapësirë e gjerë i lejohet shtetit, sipas Konventës, kur vjen puna te masat e gjera të strategjive ekonomike dhe sociale (*James and Others kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 shkurt 1986, § 46, National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society and Yorkshire Building Society kundër Mbretërisë së Bashkuar, 23 tetor 1997, § 80, çështja Stec dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 12 prill 2006*).

11. Hapësira e vlerësimit të shtetit është e gjerë kur bëhet fjalë për të drejta të natyrës social-ekonomike, kështu që është në hapësirën e vlerësimit të ligjvënësit ky trajtim i diferencuar, e cila quhet e tejkualuar, nëse një rregullim ligjor që ai bën konsiderohet si i padrejtë dhe i pajustificuar (*vendimi nr. 34, datë 20.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, mendojmë se argumentet e dhëna nga ISSH-ja, si dhe KM-ja shpjegojnë qëllimin e përligjur të ligjvënësit. Për më tepër, ligjvënësi ka dhe një *hapësirë veprimi* e vlerësimi mbi faktin nëse duhet të bëjë diskriminim pozitiv,

nëpërmjet cilit mekanizëm ndërhyrës dhe në cilat raste apo shkaqe të mbrojtura nga diskriminimi.

13. Sipas ISSH-së, përfitueset gra, nga viti 2000 deri në vitin 2032 nuk plotësojnë njërin nga kushtet, që është periudha e sigurimit në momentin e arritjes së moshës për pension pleqërie, duke mos përfshirë periudhën e studimit në shkollat e larta. Mosha për pension në vitin 2000 ishte 55 vjeç, ndërsa periudha e sigurimit e kërkuar ishte 28 vjet. Nga përfundimi i shkollës së lartë grua nuk plotësonte periudhën e sigurimit. Ndërsa burrat në vitin 2000 e kishin moshën për pension 60 vjeç dhe periudhën e sigurimit 31 vjet, të cilat i plotësonin. Nga diferenca e këtyre kriterëve, burrat duhej ta fillonin punën në moshën 29-vjeçare pa ndërprerje deri në mbushjen e moshës për pension, periudhë e cila plotësohej.

14. Me ndryshimet e ligjit nr. 7703/1993 me ligjin nr. 104/2014, në nenin 92, grua duhet të ketë moshën 63 vjeç e dy muaj dhe 40 vjet sigurim për vitin 2033, diferenca e këtyre kriterëve (moshë dhe vjetërsi), nga viti i përfundimit të shkollës së lartë deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, plotëson periudhën e sigurimit. Për meshkujt, në vitin 2033 mosha është 65 vjeç e një muaj dhe 40 vjet punë, diferenca e këtyre kriterëve nga përfundimi i shkollës së lartë deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, plotëson periudhën e sigurimit. Nga viti 2033 për përfitim pension pleqërie nuk përfshihet më periudha e shkollës së lartë si vite të siguruara për gratë, duke barazuar kriteret mes burrit dhe gruas.

15. Pra, masat pozitive (*affirmative actions*) legjitimohen të ndërmerren ndaj grupeve, sikundër gratë në rastin konkret, të cilat ndodhen në pabarazi faktike, me prejardhje historike/ sociale/ekonomike, në raport me pjesën tjetër të shoqërisë, dhe me qëllim arritjen e barazisë midis këtyre grupeve dhe pjesës tjetër të shoqërisë. Në pamje të parë këto favore dhe mundësi shtesë kuptohen si negative, megjithatë kjo formë diskriminimi legjitimohet me qëllimin e mirë të zhdukjes së pabarazisë të grupeve të caktuara, duke siguruar në këtë mënyrë një drejtësi sociale më të madhe.

16. Nga sa më lart, rezulton se ky diferencim është përzgjedhur si mekanizëm për një periudhë të caktuar kohe, dhe për më tepër si trajtim në kuadrin e skemës së përfitimeve nga sigurimet shoqërore, me kah dhe trend drejt diskriminimit pozitiv mbi baza gjinie. Përderisa standardet



ndërkombëtare inkurajojnë moshë të njëjtë për daljen në pension të burrave dhe grave, gjë që sipas ISSH-së është politikë shtetërore e miratuar tashmë, është gjetur kjo lloj ndërhyrje, duke u dhënë përparësi viteve të shkollës së lartë për gratë, për të arritur barazinë në trajtim. Situata faktike shoqërore nuk ka qenë njësoj si për burrat, ashtu edhe për gratë, prandaj dhe është ndërhyrë pozitivisht.

17. Ashtu sikundër Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj, trajtimi i diferencuar lejohet nëse ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës dhe të akteve ndërkombëtare, prandaj dhe bazuar në standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit mendojmë se kërkesa duhej rrëzuar për pretendime të pabazuara nga pikëpamja kushtetuese.

18. Si konkluzion, pretendimet e kërkuës për cenim të parimit të mosdiskriminimit nuk qëndrojnë dhe, për rrjedhojë kërkesa duhej rrëzuar për pathemeltësi dhe jo për mungesë legjitimiti të gjykatës referuese.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 2, datë 19.1.2018

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME HIMARË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë me:

Drejtues ligjor: Andrea Goro

Drejtues teknik: Fatjon Beqiraj.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Himarë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të kësaj shoqërie janë njësitë administrative Himarë dhe Lukovë (Bashkia Himarë)

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare (njëvjeçare). Brenda këtij afati kohor shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Himarë duhet të përfshijë në zonën e shërbimit edhe njësinë administrative Horë-Vranisht.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

VENDIM

Nr. 10, datë 19.2.2018

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU BERAT, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 19.2.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar
Denar Biba	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Hysen Osmanaj	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit z. Eduard Halimi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, dhe neni 175, pika 2, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 518/1 prot., datë 12.2.2018, drejtuar KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Eduard Halimi, deputet i zonës zgjedhore Qarku Berat.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të heqjes dorë nga mandati i deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25.6.2017, si dhe miratoi listën shumemërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt, për çdo zonë zgjedhore.

Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore Qarku Berat, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 1 mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Berat, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një) z. Eduard Ismail Halimi.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike, Qarku Berat, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, dhe konkretisht nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidat nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi sanksionin administrativ me gjobë në masën 12.000.000 lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PD-së, në Zonën Zgjedhore Qarku Berat duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

Në bazë të listës shumemërore të Deklaratës Model 03, kandidati i radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar me nr. rendor 6 është znj. Juvina Jani dhe me nr. rendor 7 është znj. Monika Qosja. Me shkresën nr. 189 prot., datë 12.2.2018, znj. Juvina Jani, ka paraqitur dorëheqjen nga kandidimi, zgjedhja apo mandati për deputete të Partisë Demokratike, Qarku Berat. Në bazë të shkresës nr. 188 prot., datë 12.2.2018, znj. Monika Qosja ka paraqitur dorëheqjen nga kandidimi dhe zgjedhja si deputete e Partisë Demokratike, Qarku Berat.

Sipas Deklaratës Model 03 rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumemërore Qarku Berat, pas dorëheqjes së znj. Juvina Jani dhe znj. Monika Qosja, shteron.

Sipas listës shumemërore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, kandidati vijues është kandidati i cili renditet me numër rendor 02 (dy), z. Astrit Ferik Veliaj. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për Kuvendin e Shqipërisë, nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Eduard Halimi dhe shterimit të kandidateve të gjinisë femërore, është z. Astrit Ferik Veliaj.

KQZ-ja, me vendimin nr. 288, datë 5.5.2017, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike, për 12 zonat zgjedhore.

Referuar nenit 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Astrit Ferik Veliaj ka depozituar formularin e vetëdeklarimit në KQZ, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Në zbatim të nenit 11, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione



publike”, dhe Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja bëri publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit dhe verifikimin e të dhënave në këtë formular.

KQZ-ja, me shkresën nr. 201 prot., datë 14.2.2018, kërkoi informacion nga zyra e gjendjes civile, dhe me shkresën nr. 200 prot., datë 14.2.2018, kërkoi informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet në listën shumëmbrore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, z. Astrit Ferik Veliaj.

Sipas informacionit të ardhur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, rezulton se z. Astrit Ferik Veliaj, kandidat për deputet në listën shumëmbrore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, është i padënuar nga gjykatat Shqiptare.

Sipas informacionit të ardhur nga Zyra e Gjendjes Civile me shkresën nr. 4448/1 prot., datë 6.7.2017, rezulton se z. Astrit Ferik Veliaj, deri më datë 6.7.2017, nuk ka kryer ndryshime në gjenealitetet e tij. Informacioni në lidhje me ndryshimet e mundshme, që mund të ketë pas datës 6.7.2017, nuk ka ardhur akoma nga Zyra e Gjendjes Civile.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Astrit Ferik Veliaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PËR KËTO ARSYE:

Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, dhe neni 175, pika 2, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmbrore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, z. Astrit Ferik Veliaj.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETARI
Klement Zguri

KËRKESË

Shtetasi Sokol Kucuku, i datëlindjes 19.9.1955, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzo Veip Kucuku, i datëlindjes 5.4.1926, në datën 31 dhjetor 2000.

KËRKUES
Sokol Kucuku

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë